

PER KRYERJEN E FUNKSIONEVE

Këshilli i Qarkut Shkodër në kryerjen e funksioneve të veta ndërton dhe zbaton politikat lokale, rajonale dhe harmonizimin e tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër dhënë me ligj, duke synuar konkretisht të realizojë:

- Bashkëpunimi me universitetet apo institucione të specializuara vendase apo të huaja, për kërkime dhe inovacione, për transferimin e teknologjive bashkëkohore si dhe aplikimin praktikave të përparuara në territor.
- Bashkëpunim me Ministrinë e linjës dhe Zyrat Rajonale përkatëse si dhe institucione të tjera vendore apo dhe jo publike duke koordinuar ato nëpërmjet bordit rajonal të punësimit, aplikimin e strategjisë rajonale të punësimit.
- Bashkitë krijojnë dhe administrojnë shërbime për territorin e tyre, Këshilli i Qarkut mundëson shpërndarjen e shërbimeve në ato njësi ku ato mungojnë sipas nevojave të vlerësuara.
- Krijon një data-base mbi gjendjen social ekonomike të territorit qarkut për realizimin dhe zbatimin e një pakti social.
- Mbledh problemet dhe krijon tematikat sociale sidomos për fenomenet dhe nevojat aktuale të zhvillimit.
- Fokuson ndërhyrjet sociale nëpërmjet fondit social rajonal duke ju përgjigjur nevojave të ndërhyrjes në kohe optimale
- Në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e linjës, kërkon të orientojë zhvillimin e arsimit të mesëm profesional sipas nevojave të tregut rajonal të punës, sipas studimeve dhe analizave perkatëse.
- Të angazhohet vetë, apo në bashkëpunim me njësi të tjera vendore dhe Organizata jofitimprurëse, sikurse dhe të krijojë agjenci e njësi të tjera vartësie, për tu përfshirë në programet e bashkimit evropian në nivel vendor duke mundësuar që nëpërmjet projekteve të veçanta të realizojë aktivitete në zbatim të politikave të zhvillimit të territorit e të vetë Institucionit.

